

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                               |
|---------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | AfD e hapur për takim me përfaqësuesit e Moskës                                                                                                                                               |
| ADRESA  | <a href="https://www.gazetatema.net/bota/afd-e-hapur-per-takim-me-perfaqesuesit-e-moskes-i587071">https://www.gazetatema.net/bota/afd-e-hapur-per-takim-me-perfaqesuesit-e-moskes-i587071</a> |
| BURIMI  | gazetatema.net                                                                                                                                                                                |
| GJENDJA | online                                                                                                                                                                                        |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 19 shtator 2026, 12:17:52 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 19 shtator 2026, 12:15:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 008c4d83f3bd30299b4d76a080433f63159036f5cfba8badaaaae95d94d14ae8 |
| TEKSTI     | 043d87719afb1f61353bef5fa6546b839ccabe54673548e165998d1875ff7bf8 |
| PAMJA      | 4aa3801b20133d297ff6ee936efe35999ac12845697bcf775a5efe1d121ace11 |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 3f6a9f60a7a50bedc11f73ab8a71695d03f41483dcd1a0b534de49157b614f63                                                                                                   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                                                                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | —                                                                                                                                                                  |
| ANKORIMI      | nuk është ankoruar ende<br><i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3f6a9f60a7a50bedc11f73ab8a71695d03f41483dcd1a0b534de49157b614f63>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px





- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by

[Kontakt](#)



English



ie AfD e hapur për takim me përfaqësuesit e MoskesU ia jashte listes se Kombetares, "shperthen" sulmuesi: Po rri urte, me mire te mos flas me... Programi "Pas Shkolles", h fundit

## AfD e hapur për takim me përfaqësuesit e Moskës



19 Shtator 2026, 14:15Bota TEMA



Ajencia e lajmeve Reuters raporton se përfaqësuesi kryesor ekonomik i Presidentit rus Vladimir Putin dhe udhëheqja e partisë së ekstremist të djathtë gjerman, AfD, kanë nisur përgatitjet për një takim vitin e ardhshëm, me qëllim diskutimin e rifillimit të furnizimeve me gaz për ekonominë më të madhe të Evropës.

Në takim pritet të marrin pjesë Kirill Dmitriev, këshilltar i afërt i Putinit dhe kreu i fondit sovran të pasurisë së Rusisë, si dhe bashkë-udhëheqësit e AfD-së, Alice Weidel dhe Tino Chrupalla.

Para sanksioneve të vendosura si pasojë e pushtimit rus në shkallë të plotë të Ukrainës në vitin 2022, Rusia siguronte më shumë se një të tretën e importeve gjermane të naftës bruto dhe më shumë se gjysmën e gazit natyror.

Takimi do të zhvillohet vetëm nëse fillimisht arrihet një marrëveshje për një kornizë paqeje mes Rusisë dhe Ukrainës; burimet e Reuters thanë se organizatorët shpresonin se takimi do të bashkonte AfD-në, Rusinë dhe Shtetet e Bashkuara. Si vende të mundshme për samitin u përmendën Izraeli, Emiratet e Bashkuara Arabe ose India.

Organizatorët shpresonin se Witkoff dhe Kushner do të merrnin pjesë edhe në takimin për gazin, i cili do të shqyrtonte mundësinë e rihapjes së gazsjellësve rusë "Nord Stream".

Një zyrtar i lartë amerikan deklaroi për Reuters se Witkoff dhe Kushner nuk janë informuar dhe as nuk janë ftuar në samitin e propozuar.

Burimet thanë për Reuters se AfD-ja shpreson se takimi mund të demonstrojë kompetencën e saj në politikën e jashtme dhe të nxjerrë në pah mosveprimin e qeverisë përballë çmimeve të larta të energjisë.

## Lini një Përgjigje

Koment \*

Emër \*

POSTOJE KOMENTIN

[Sondazhi: 48 për qind e gjermanëve presin largimin e Merz deri në fund të vitit](#)

13:45 Bota

[SHBA dhe Egjipti diskutojnë krizat rajonale, këshilltari i Trumpit telefonon Kajron: Po cenohet siguria](#)

13:15 Bota

## Përplasje në horizont? Izraeli kërkon “kompensim” nga SHBA-të

12:55 Bota

11:35 Bota

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.